

Specialist në Sektorin e Koordinimit për NSDI, në Drejtorinë Koordinimit dhe Projekteve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Koordinimit për NSDI, në Drejtorinë e Koordinimit dhe Projekteve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Merr pjesë në hartimin e akteve administrative dhe nënligjore (forma, procedura dhe përmbajtja gjuhësore dhe ligjore) që lidhen me krijimin, përditësimin, shkëmbimin aksesin dhe përdorimin e informacionit gjeohapësinor dhe shërbimet e gjeohapësinore.
2. Përgjigjet për bashkërendimin institucional me autoritetet përgjegjëse për respektimin e standardeve shtetërore dhe rregullave uniforme (administrative dhe teknike) për krijimin, përditësimin dhe administrimin e infrastrukturës gjeohapësinore për temat përkatëse sipas nenit 11 të ligjit nr. 72/2012.
3. Ndjek zbatimin e afateve dhe procedurave nga autoritetet përgjegjëse për depozitimin e nismave apo sistemeve të informacionit gjeografik sipas përcaktimeve në ligjin nr. 72/2012 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
4. Përgjigjet për organizimin, evidentimin dhe publikimin e aktiviteteve, hartimin dhe publikimin e materialeve për arritjet e ASIG në përmbushje të objektivave institucionale.
5. Përgjigjet për komunikimin me publikun lidhur me shërbimet që ofrohen nga ASIG nëpërmjet Gjeoportalit Kombëtar apo zbatimin nga institucioni të planit të komunikimit dhe programit të transparencës bazuar në kuadrin ligjor përkatës.
6. Kontrollon dhe redakton nga pikëpamja gjuhësore apo e përputhshmërisë ligjore dhe teknikës së hartimit draftet e akteve nënligjore dhe relacioneve shpjegues të paraqitura nga sektorët përkatës para se ato të dërgohen për miratim.
7. Përgjigjet për organizimin e mbledhjeve të Bordit të Informacionit Gjeohapësinore (BIG), sigurimin e infrastrukturës së nevojshme, përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e nevojshëm që do të shqyrtohet në BIG dhe dokumenton me shkrim mbledhjet e BIG, në zbatim të rolit të ASIG si sekretariat teknik i BIG.

8. Zbaton detyrat që i ngarkohen nga strukturat e prora lidhur me procedurat që zhvillohen për organizimin e aktiviteteve brenda vendit apo në kuadër të bashkëpunimit me partnerë apo organizata ndërkombëtare në fushën e gjeoinformacionit.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

- Të zotërojë diplomë Arsimit: Diplomë “Master profesional” në Shkenca Juridike/ “Master profesional në Shkenca Shoqërore.
- Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune;
- Të ketë njohuri të gjëra të fushës, të teknikës së hartimit të akteve dhe dokumenteve institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, aftësi për të vlerësuar opsione zgjidhjesh dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.
- Aftësi të mira komunikimi e raportimi, si dhe aftësi për të punuar ne grup.
- Të ketë eksperiencë në organizimin e takimeve, seminareve në sektorin që mbulon ASIG.
- Të njohë mirë kuadrin ligjor dhe nënligjor që lidhet me Infrastrukturën Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor dhe kuadrin ligjor të autoriteteve përgjegjëse, sipas nenit 11 të ligjit nr. 72/2012, për këtë informacion si dhe legjislacionin e BE që lidhen me gjeoinformacionin (Direktiva INSPIRE).
- Të njohë shumë mirë gjuhën angleze, dhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.
- Të ketë njohuri të programeve dhe aplikacioneve bazë të kompjuterit;
- Vlerësohen certifikimet për sa më lart.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-a)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 21.07.2023, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.